



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRY SHE

05 gusht 2015, Prizren

Komunikatë për medie

Portali mahalla.info në shërbim të aktivizmit të qytetarëve të Prizrenit

EC Ma Ndryshe të mërkurën ka lansuar portalin www.mahalla.info, që i dedikohet aktivizmit të qytetarëve dhe grupeve të komunitetit në lagjet brenda qytetit të Prizrenit.

Para gazetarëve është ofruar një shpjegim më i gjerë për përmbajtjen e portalit si dhe rubrikat brenda tij, të cilat mund të shfrytëzohen nga qytetarët për të adresuar propozime, ankesa, paralajmërime në lidhje me zhvillimet në lagjet e tyre si dhe të mbikëqyrin realizimin e projekteve që zbatohen në saje të mjeteve publike.

Në portal, vizitorët mund të gjejnë informata mbi takimet nëpër lagje, vizionin e qytetarëve për lagjen e tyre, performansat e realizuara publike për të adresuar brenga të ndryshme, projektet që janë në realizim, pastaj të dhënat për problemet e identifikuar në lagjet e caktuara, për hapat e aktivizmit për adresimin dhe zgjidhjen e tyre, zgjidhjet e prodhuara, etj., të cilat tani e tutje do të përditësohen në baza ditore.

Portali mahalla.info është zhvilluar nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Qyteti gjithëpërfshirës...", financuar nga Olof Palme International Center (OPIC), e cila përkrahet nga Qeveria e Suedisë. "Qyteti gjithëpërfshirës..." është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Grupet e komunitetit me të cilat punohet në këtë projekt janë të shpërndarë në lagje të ndryshme të qytetit dhe paralelisht zhvillohet edhe procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Me respekt,
Fisnik Minci, koordinator projekti
OJQ EC Ma Ndryshe

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë

